

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“WHITE ROADS HOTEL” SH.P.K.  
DATË 26.11.2020**

Sot, në datën 26.11.2020, Shoqëria “Gjikuria” shpk, me NIPT J62903456H, me adresë në Rruga “Ibrahim Rugova”, pranë Gardës së Republikës, Pallati Kontakt, mbi Union Bank, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z. Florenc Gjikuria, atësia Milo, i datëlindjes 12.01.1973, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Memaliaj, Tepelenë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit 031406006 dhe me numër personal H30112006D, në cilësinë e Ortakut të vetëm Themelues, vendosi, me miratimin e Asamblesë së Ortakëve, sipas Vendim nr. 33, datë 23.11.2020, të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **“White Roads Hotel” Shpk**. Kjo shoqëri do të realizojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si Shtojca A.

**NENI 1 – EMËRTIMI**

- 1.1 Shoqëria emërtohet **“WHITE ROADS HOTEL” Shpk** (në vijim “Shoqëria”).

**NENI 2 – FORMA**

- 2.1 Shoqëria **“WHITE ROADS HOTEL” Shpk** themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**NENI 3 – SELIA**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Pasuria nr. 4/90-N17, volum 68, faqe 204, zona kadastrale 8270, Rr. “Ibrahim Rugova”, pranë Gardës se Republikës se Shqipërisë, Pallati Kontakt, Kati 2, mbi Union Bank, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresë të tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresë sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

**NENI 4 – OBJEKTI**

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:

- a. Projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi dhe operimi i strukturave hoteliere dhe/ ose objekteve turistike sezonale, administrimi i tij/tyre dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit në këtë zone, përfshirë edhe çdo veprimtari tjetër plotësuese, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur.
- b. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari tregtare të tjera, që lidhen me pasuri të luajtshme dhe te paluajtshme, të marrë me qira pasuri të luajtshme, të paluajtshme, ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluar apo në themelim e sipër.
- c. Krijimi i faqeve web, platformave elektronike ne internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë edhe nëpërmjet pajisjeve elektronike te komunikimit ne distance.
- d. Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.

#### **NENI 5 – KOHËZGJATJA**

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 1 kuotë të zotëruar nga ortaku i vetëm themelues në masën 100% e kontributit në kapital.
- 6.2 Kuotat e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjislacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortaku Themelues, në masën 100%.
- 6.4 Ortaku/ secili nga Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të saj.

#### **NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE**

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutit e Shoqërisë.

#### **NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT**

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të

- gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme (“*ad negotia*”) për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:  
 “Z. Florenc Gjikuria, shtetas shqiptar, lindur më 12.01.1973, në Memaliaj, Tepelenë, banues në adresën: Mullet, Tirane, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 031406006 dhe me numër personal H30112006D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.”

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
Floreec Gjikuria	

#### NENI 9 – GJUHA

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


#### NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

- 10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\* \* \*

Miratuar nga:

ORTAKU THEMELUES:

  
 Shoqëria “Gjikuria” shpk  
 Përfaqësuar nga:  
 Florenc Gjikuria